STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

**Për Njoftim të Menjëhershëm:** 8 mars 2013

**GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) NJOFTON RIVENDOSJEN E SHERBIMIT TE METROSE SAUTH FERI (SOUTH FERRY)**

***Platforma e vjetër e qarkut do të rihapet ndërsa rindërtohet stacioni i ri***

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot se shërbimi i trenit 1 do të kthehet në platformën e një qarku të stacionit të metrosë të Sauth Ferit (South Ferry) të shkatërruar nga stuhia në javën e parë të prillit, duke e bërë udhëtimin më të lehtë për më shumë se 10,000 udhëtarë të përditëshëm në cepin jugor të Manhatanit (Manhattan) ndërsa vazhdon një rindërtim i plotë.

"MTA ka një punë të gjatë, të vështirë përpara ndërsa merret me punën e stërmadhe të praktikisht rindërtimit të stacionit të terminalit Sauth Feri (South Ferry) që u përmbyt nën 80 këmbë ujë gjatë super stuhisë Sandi (Sandy)," tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). "Për periudhën e gjatë të kohës që do të duhet që kjo punë të përfundojë, jemi duke rikthyer stacionin e vjetër të kompleksit në shërbim, duke e bërë udhëtimin më të lehtë dhe më të leverdisshëm për banorët e Stejtën Ajlënd (Staten Islanders) dhe të tjerë që punojnë dhe vizitojnë këtë zonë."

Vërshimi i stuhisë Sendi (Sandy) dërgoi një rrebesh uji me kripë në stacionin e Sauth Ferit (South Ferry) në 29 tetor. Rreth 15 milionë gallona ujë mbushën zonën nga niveli i shinave tek niveli i mesëm, duke shkatërruar të gjitha sistemet dhe elementët elektrike e mekanike dhe duke e bërë stacionin të papërdorshëm. Si rezultat, trenat 1 tani përfundojnë në Rector Street, një shqetësimi i madh për mijëra udhëtarë dhe vizitorë çdo ditë.

Të përballur me një afat kohor rreth dy vjeçar për rikthimin e stacionit të ri Sauth Feri (South Ferry), MTA Tranziti i Qytetit të Nju Jorkut (New York City Transit) studjoi stacionin e dikurshëm të qarkut drejt sipër tij që i shërbeu Sauth Ferit (South Ferry) deri më 2009. Stacioni është në një kthesë të mprehtë dhe kërkon zgjatës të lëvizshëm të skajit të platformës për të mbyllur hapësirat ndërmjet platformës e vagonave dhe mund të mbajë vetëm pesë vagona të një treni metroje me dhjetë vagona.

"Ndërsa MTA Tranziti i Qytetit të Nju Jorkut (New York City Transit) vlerësoi sferën e dëmit të stacionit të ri Sauth Feri (South Ferry), u bë e qartë se koha e nevojshme për t'a riparuar atë do të ishte një periudhë shumë e gjatë për t'u mohuar udhëtarëve tanë një lidhje të drejtpërdrejtë me Mahnatanin

(Manhattan) e poshtëm," tha Drejtori Ekzekutiv i Përkohëshëm i MTA-së Tomas F. Prendergast (Thomas F. Prendergast). "Jemi duke punuar për t'u siguruar se të gjithë elementët dhe sistemet janë plotësisht funksionale, të sigurta dhe të besueshme përpara rivendosjes së shërbimit në stacionin e vjetër, por qëllimi ynë kryesor mbetet rikthimi i stacionit të Sauth Ferit (South Ferry) sa më shpejt që të jetë e mundur."

Puna për të rihapur Sauth Ferin (South Ferry) e vjetër përfshin hapjen e një pike të re lidhje ndërmjet katit të mesëm të stacionit të ri dhe stacionit të vjetër të qarkut, e cila do të lejojë një transferim ndërmjet trenit 1 dhe stacionit Whitehall Street të trenit R.

Puna tjetër përfshin rinovimin e zgjatësve të lëvizshëm të skajit të platformës dhe zëvendësimin e pistonave dhe elementëve të tjerë. Ekipet duhet të instalojnë ushqyesit elektrikë, sistemet televizivë me qark të mbyllur për të mbikqyrur platformën, pajisjet e komunikimit të ndihmës për udhëtarët, kamerat e sigurisë dhe komunikacionet e radios në zyrën e dispeçërit. Punë shtesë do të kërkohet për të restauruar zonën e kontrollit të pagesës, rivendosjen e ndriçimit në stacion dhe tunelet aty pranë, instalimin e ndriçimit të ri për platformën dhe riparimin e rilyerjen e mureve të stacionit. Kostoja e vlerësuar e rikthimit të stacionit të vjetër të qarkut Sauth Feri (South Ferry) në shërbim është 2 milionë dollarë.

Administrata Federale e Tranzitit (Federal Transit Administration) e ka rimbursuar MTA Tranzitin e Qytetit të Nju Jorkut (New York City Transit) për shumën fillestare prej 629,100 dollarë për punën e rimëkëmbjes në stacionin e ri të South Ferit (South Ferry), e cila përfshiu largimin me pompa të ujit, heqjen e mbeturinave, vlerësimin e dëmit dhe inspektimin e pajisjeve.

Ky fond fillestar i FTA-së rimburson MTA për kostot e pësuara gjatë përgatitjes për stuhinë deri në 29 janar. Ai është raundi i parë i financimit që MTA ka marë për të ndihmuar në rimëkëmbjen nga Sendi (Sandy) dhe për të rindërtuar më fuqishëm.

MTA është duke punuar nga afër me FTA për të ndjekur rimbursimin për kostot e rindërtimit të stacionit të shkatërruar.

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418